

## Kart' e-dytë e apostollit Joan.

- 1 Unë plaku mbë Zonjën' e-sgjedhurë, edhe mbë bijt' e asaj, të-cilëtë un' i dua me të-vërtetë; edhe jo vetëm' unë, po edhe gjith' 2 ata që kanë njohurë të-vërtetënë; Për të-vërtetënë që mbetetë ndër ne, edhe dotë jetë 3 bashkë me ne për gjithë jetënë; Qoftë bashkë me ju hir, përdëllim, paqtim prej Perëndisë, Atit, edhe prej Zotit Jisu Krishtit, Birit t' Atit, ndë të-vërtetë e ndë dashuri.
- 4 Ugëzuashë shumë, se gjeta *ca* nga bijt' e tu dyke ecurë ndë të-vërtetët, sikundrë muar- 5 më porosi prej Atit. Edhe tashi të lutem ty,

- o Zonjë, jo sikur se të shkruanj *ndonjë* porosi të-re, po atë që kishimë që ndë kryet, 6 të duamë njëri tjetërinë. Edhe këjo është dashuria, të ecëjmë pas porosivet t' ati. Këjo është porosia, sikundrë e dëgjuatë që ndë kryet, të ecëni mb' atë.
- 7 Sepse shumë kobimtarë hynë ndë botët, të-cilëtë nukë rrëfenjënë se Jisu Krishti erdhi ndë mish; i-tilli është kobimtari edhe anti- 8 krishti. Vështroni vetëhenë t'uaj, që të mos humbasëm' ato që punuamë, po të marrëmë 9 pagë të-plotë. Kushdo që shkel *porosinë* edhe nukë mbetetë ndë mësimt të Krishtit, ky nukë ka Perëndi; ay që mbetetë ndë më- 10 simt të Krishtit, ky ka edhe Atin' edhe Bi- rinë. Ndë goftë se vjen *ndonjë* ndër ju, e nukë bje këtë mësim, mos e merrni ndë 11 shtëpi, edhe mos i thoni ati, Gëzuash; Sepse ay që i thotë ati, Gëzuash, bënëte pjesëtar ndë punërat t' ati të-liga.
- 12 Ndonëse pata shumë për të shkruarë juve, nukë desha me kartë e me mellan t' u'a shkruanj; po shprenj të vinj te ju, edhe të flas gojë për gojë, që të jetë i-plotë gëzimi ynë.
- 13 Të falenë me shëndet djemt' e s' at mo- tëre së-sgjedhurë. (Amin.)